



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
MATEMATIKA

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: ff5d48140e4e

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik, gomë, vizore, trekëndësh dhe kompas, por jo kalkulatorin.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Te ato detyra tek të cilat ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR
Tek detyra me një përgjigje të saktë
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. <input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5. <input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5

- Nëse testin e përfundon para kohës së paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
MATEMATIKA

1. Në tabelë janë paraqitur matjet nga disa stacione hidrometeorologjike në datën 09.8.2022.

Lumi	Stacioni hidrometeorologjik	Niveli i ujit(cm)
Sava	Mitrovica e Sremit	-3
Sava	Shabac	-110
Sava	Beograd	162
Morava Madhe	Varvarin	-216
Morava Madhe	Çupri	-112
Morava Madhe	Bagrdan	-44
Morava Madhe	Ura e Lubiçevës	-364
Morava Jugore	Aleksincë	-162

Në cilin stacion janë matjet më të ulta të Savës?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- Mitrovica e Sremit Shabaci Beograd Varvarin Ura e Lubiçevës

2. Në shkollë janë 656 nxënës. Vajzat përbëjnë pesë përqind nga numri i përgjithshëm i nxënësve. Cila nga shprehjet e mëposhtme e paraqet numrin e vajzave në atë shkollë?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- $\frac{5}{8} : 656$
 $\frac{8}{5} : 656$
 $\frac{5}{8} \cdot 656$
 $\frac{8}{5} \cdot 656$

3. Çfarë monomi duhet të shkruhet brenda katrorit në mënyrë që shprehja mos të ndryshojë vlerë për çdo a dhe b ?
 $-3ab \cdot \square = -21a^2b^2$

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- $7a$ $7b$ -7 $7ab$ $-18ab$ $-7ab$






4. Në rretën katrore janë dhënë shkronjat E, P dhe O. Le të jenë P_E , P_P dhe P_O sipërfaqet e shkronjave E, P dhe O. Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

$P_E < P_O < P_P$

$P_E = P_O = P_P$

$P_E > P_O > P_P$

$P_P = P_E < P_O$



5. Paketimi i lëngut ka formën e një kuboidi me përmasa $7 \text{ cm} \times 8 \text{ cm} \times 21 \text{ cm}$. Me cilën nga shprehjet e mëposhtme mund të llogarisim vëllimin e paketimit? Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

$7 + 8 + 21$

$\sqrt{7^2 + 8^2 + 21^2}$

$7 \cdot 8 + 7 \cdot 21 + 8 \cdot 21$

$2 \cdot (7 \cdot 8 + 7 \cdot 21 + 8 \cdot 21)$

$7 \cdot 8 \cdot 21$

$2 \cdot (7 \cdot 8 \cdot 21)$

6. Parashutizmi është një nga sportet ajrore. Lartësia dhe gjatësia e fluturimit varet nga moti. Iliri në Rajc ka bërë një fluturim prej 5,64 km. Sa është kjo gjatësi në metra?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

564 m

5 640 m

56 400 m

564 000 m






7. Kaltrina në shitore pagoi faturën 367 dinarë. Shitësit i ka dhënë shumën e saktë, ndërkaq mes kartëmonedhave dhe monedhave të metalit me të cilat ka paguar nuk kishte dy të njëjta. Çfarë lloje të kartëmonedhave dhe të monedhave i ka dhënë Kaltrina shitësit?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- | | | |
|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| <input type="radio"/> 1 dinar | <input type="radio"/> 2 dinarë | <input type="radio"/> 5 dinarë |
| <input type="radio"/> 10 dinarë | <input type="radio"/> 20 dinarë | <input type="radio"/> 50 dinarë |
| <input type="radio"/> 100 dinarë | <input type="radio"/> 200 dinarë | <input type="radio"/> 500 dinarë |

8. Në figurë është paraqitur tabela e lojës së shahut me figura. Në tabelën tjetër janë paraqitur figurat dhe emërtimi i tyre.



Cila nga figurat është në g7?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- | | | |
|------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------|
| <input type="radio"/> Mbreti | <input type="radio"/> Mbretëresha | <input type="radio"/> Topi |
| <input type="radio"/> Kali | <input type="radio"/> Oficeri | <input type="radio"/> Piuni |

9. Për çdo vit në bibliotekë për shkak të dëmtimit, ndërrohen 3% nga numri i përgjithshëm i librave. Në bibliotekë para ndërrimit të librave gjithësej ishin 9 000 libra. Sa nga ato 9 000 libra duhet të ndërrohen?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 90
- 180
- 270
- 300
- 450
- 540
- 900





10. Është dhënë shprehja $A = -10 + (-8 + 16)$.
Ngjyros rrethin përpara çdo përgjigjeje të saktë.

	$-\frac{1}{2}$	-2	$\frac{1}{2}$	2
Vlera e shprehjes A është	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vlera absolute e A është	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vlera reciproke e A është	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

11. Mentori është bletar i cili ka 25 koshere. Ai pret gjatë këtij viti të marrë mesatarisht 50 kg mjaltë për çdo koshere. Nga gjithësej sasia e mjaltës, do të dhurojë 100 kg familjarëve dhe shokëve, ndërsa pjesën e mbetur ai do ta shesë 1 200 dinarë për kilogram. Parashikoi se shpenzimet të cilat do t'i ketë për material dhe për derivate do të jenë 600 000 dinarë. Sa do të fitojë në bazë të këtyre vlerësimeve Mentori këtë vit nga mjalti?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- 370 000 dinarë
- 525 000 dinarë
- 780 000 dinarë
- 900 000 dinarë
- 1 500 000 dinarë

12. Sa është prodhimi i vlerave numerike i të panjohurave, të cilat janë zgjidhje të sistemit të ekuacioneve me dy të panjohura?

$$\begin{cases} 1,2x - 2y = -12 \\ 3x + 0,5y = 3 \end{cases}$$

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- $x \cdot y = 12$
- $x \cdot y = 6$
- $x \cdot y = -6$
- $x \cdot y = 0$






13. Nëse $A = \frac{7^8 \cdot (7^3)^2 : 7^4}{7^6 \cdot 7^4}$ cilit interval i takon vlera e shprehjes $\sqrt{1 + A}$?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- [0,1)
- [1, 2)
- [2, 3)
- [3, 4)
- [4, 5)
- [5, 6)


14. Sa shkallë ka këndi kundërt i këndit β të treguar në figurë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 33°
- 57°
- 123°
- 147°
- 157°



15. Sa është gjatësia e brinjës AB në figurë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 4 cm
- 5 cm
- 6 cm
- 7 cm
- 8 cm





16. Lirika para se të shkonte në pushime, 58 500 dinarë i ka shndërruar në euro në këmbimore, me kurs të këmbimit 117 dinarë për një euro. Në pushime të gjitha eurot i ka shndërruar në lira turke me kurs këmbimi 18 lira për një euro. Sa lira turke ka marrë gjithësej Lirika gjatë këtij këmbimi?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 30 lira
- 300 lira
- 900 lira
- 9 000 lira

17. Banka çdo ditë ndërron kodin për hapjen e kasafortës. Katër shifra të shkruara sipas kësaj radhitjeje krijojnë kodin $xyzt$. Kodin e fitojmë ashtu që së pari formojmë numrin A , i cili fitohet me ndihmën e numrit rendor të ditës dhe muajit në datën e asaj dite. (p.sh. për 25.03 $A = 2503$), ku është:

x – mbetja gjatë ndarjes së numrit A me 2

y – mbetja gjatë ndarjes së numrit A me 3

z – mbetja gjatë ndarjes së numrit A me 5

t – mbetja gjatë ndarjes së numrit A me 9

Cili kod do të vendoset në kasafortë në datën 30.05.2024?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 0105
- 1105
- 1108
- 1202
- 1208
- 1253





18. Ana dëshiron të marrë me qera një makinë për shtatë ditë për të vizituar disa vende nëpër Serbi. Në agjensionet të cilat japin makina me qera për të njëjtën makinë dhënë ofertat e tyre.

Oferta 1

2 500 dinarë në ditë dhe 10 dinarë për çdo kilometër të kaluar.

Oferta 2

10 000 dinarë java, 350 km e para pa pagesë, ndërsa pas këtyre nga 30 për çdo kilometër të kaluar.


Kur llogariti kilometrat e planifikuar, të cilat do bënte gjithësej për këto 7 ditë, erdhi në përfundim se do të paguajë njëjtë cilëndo nga ofertat që do marrë.

Sa kilometra Ana planifikoi të bënte?

Trego ecurinë.

Ana planifikoi të bënte _____ km.

19. Njihëso sipërfaqen **jo të hijezuar** të gjashtkëndëshit të rregullt të paraqitur në figurë, nëse brinja e tij është 6 cm. Trego ecurinë.




Sipërfaqja e pjesës **jo të hijezuar** është _____ cm^2 .





20. Diametri i bazës së cilindrit është 1dm, lartësia e konit është 13 cm, ndërsa kulmi i koni S është mesi i lartësisë së cilindrit O_1O_2 . Sa është vëllimi i pjesës së cilindrit e mbetur nga heqja e konit? Trego ecurinë.



Vëllimi i pjesës së cilindrit e mbetur nga heqja e konit është _____ cm^3 .



FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
MATEMATIKA

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

